



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:134750
Datë: 15.10.2024
Numri i dokumentit: 06296468

CAP.nr.434/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Lumni Sallauka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores A.B, të cilën e përfaqëson S.K, avokat në P..., ndaj debitorit të përmbarimit: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.841/2023, të datës 24.11.2023, me datën **10.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.841/2023, i datës 24.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar, Cpc.nr.841/2023, të datës 24.11.2023, ka vendosur si në vijim: *“I. REFUZOHET prapësimi i debitorit të përmbarimit: SHSKUK me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.841/23, të dt.26.10.2023 mbi caktimin e përmbarimit, si i pabazuar; II OBLIGOHET debitori i përmbarimit: SHSKUK në Prishtinë, që të autorizuarit kreditorit të përmbarimit t’ia kompensoi shumën prej 117.00 €, në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim”*.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e debitorit, ndërsa aktvendimin e atakuar Cpc.nr.841/2023, të datës 24.11.2023, të e anulojë si të pabazuar, të pas afatshëm dhe të palejueshëm, pasi që në bazë të nenit 391 të LPK-së kemi të bëjmë me çështje që është e gjykuar (res judicata).

Përgjigje në ankesë ka parashtruar kreditori, me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar Cpc.nr.841/2023, i datës 24.11.2023, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit **është e pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 08.06.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, me seli në Prishtinë, ndërsa gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin Cpc.nr.841/23, të datës 26.10.2023, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit përmbartimor vendimit të Inspektoratit të Punës nr.21-1715/94, datë 10.02.2020 dhe vendimit për korrigjimin e gabimeve nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020, të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm, me bazë juridike kompensimi i pagave në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 933.98 euro, si dhe shumën 176 euro në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore, të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbartim.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit Cpc.nr.841/23, të datës 26.10.2023, debitori me datën 06.11.2023, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori me datën 22.11.2023, ka ushtruar përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin Cpc.nr.841/2023, të datës 24.11.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe e ka vërtetuar urdhrin përmbartimor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar tërësisht si të pabazuar prapësimin e debitorit duke vërtetuar aktvendimin për lejimin e përmbartimit Cpc.nr.1380/2023, i datës 31.10.2023, sikurse në aktvendimin e atakuar. Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i Inspektoratit të Punës nr.21-1715/94, datë 10.02.2020, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm me datë 19.05.2020 dhe vendimit për korrigjimin e gabimeve nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020, në bazë të cilit organi përmbartues ka caktuar përmbartimin, janë tituj përmbartimor dhe si të tillë i plotësojnë kushtet e parapara në nenin 22 para. 1.2 të LPP-

së, në lidhje me nenin 23 para. 2, nenin 24, si dhe nenin 27 para.1 të LPP-së, dhe mbi këtë bazë këto dokumente me të drejtë trajtohen si dokumente të përshtatshëm për përmbartim. Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë. Ndërsa pretendimin ankimor të debitorit që ka të bëjë me parashkrimin e kërkesës dhe faktin se kjo çështje është çështje e gjykuar (res judicata) , gjykata e shkallës së dytë i vlerëson të pabazuara dhe pa ndikim në vendosjen e kësaj çështje përmbartimore. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e atakuar ka dhënë arsye të mjaftueshme për këto pretendime, të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pabazuar, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar, se në bazë të nenit 71 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi, e të cilat shkaqe po që ekzistojnë, e pengojnë përmbartimin e lejuar nga gjykata.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitivin e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore *"Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual"*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.434/2024, datë 10.10.2024

Gjyqtari,
Lumni Sallauka